



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Ledi” Sh.P.K. të datës 24.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Ledi” Sh.P.K. të datës 24.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.
- II. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Ledi” Sh.P.K. se Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës ka dërguar në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi për shkak të kërkesave të tjera për rishqyrtim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Ledi” Sh.P.K. (tutje si “parashtruesi”) me datë 24.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me numër të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë formuluar si në vijim: "Pra, ne si GOE LEDI SHPK; MB GROUP, nuk gjindemi askund ne listen e OE ofertues per LOT 4, edhe pse jemi OE me cmim me te lire se OE i rekomanduar. Ne si GOE kemi ofertuar me cmim per njesi prej 121.78 €, kurse ju si AK e keni shperblyer me kontrate OE RISAMONT SHPK me cmim njesi 132.90 €. Pra, jemi OE me cmim me te lire per cmim njesi apo me sakte jemi me i lire se OE i rekomanduar per 11.12 € Pra, nga gjitha qe u tha me larte rezulton se ju si AK na keni eliminuar duke e demtuar buxhetin e AK-se, dhe duke na diskriminuar edhe neve si GOE me cmim me te lire. -- Arsyet e eliminimit jane te paqendrueshme sepse ne si OE e kemi ofruar katalogun, autorizimin, letren e konformitetit, ku do tua bashkangjesim si prova shtese".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Nuk keni ofruar dëshmi se keni plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale.

Ne Njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen e tenderit ne piken 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 2 dhe 7 është kërkuar qe:

Kerkesa:

2. Katalogu origjinal ose kopje dhe të jetë në përputhje me specifikat teknike për trupa ndriçues- Pozicioni 1, 2, 3. Kurse vetëm për LLOTO 1 duhet të dorëzohet katalogu edhe për pozicioni 4, 5, dhe 6.

Dëshmia:

2. Katalogun për pozicionet e kërkuara

Ju nuk keni plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale pasi qe specifikimi teknik ne katalogun qe ju keni ofruar nuk përmbush specifikat e kërkuara te AK.

Përmes administrimit me ofertën e parashtruesit është gjetur se i njëjti ka dorëzuar një katalog mirëpo katalogu në fjalë nuk i përmbush specifikat teknike të kërkuara nga AK sipas poz. 1, 2 dhe 3 për lotin/et ku ka ofertuar parashtruesi. Prandaj kjo pikë e pretendimit ankimor është e pabazuar kurse konstatimi i komisionit vlerësues për eliminimin e ofertës së parashtruesit është konstatim i saktë në tërësi.

Sa i përket pikës së pretendimit ku thuhet se AK nuk ka vendosur në listë emrin e parashtruesit, duke qenë se ky AP është i ndarë në lote atëherë në listë janë vendosur vetëm OE të përgjegjshëm kurse për OE të eliminuar si të papërgjegjshëm janë dërguar letrat standarde për tenderuesit e eliminuar të cilën e ka pranuar edhe parashtruesi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 02.07.2024

Visar SHEHU


Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.